



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

Analizë e buxhetit shoqëror

Bashkia Skrapar



GUSHT 2020

Kjo analizë u përgatit nga Arlinda Ymeraj dhe Kejda Beqiri me mbështetjen e z. Fatjon Kaloçi dhe ekipit të buxhetit të Bashkisë Skrapar me mbështetjen e Programit “Përmirësimi i Ofrimit të Shërbimeve Lokale të Mbrojtjes Sociale”, një program dyvjeçar që nxit ndryshime të mëtejshme në sasinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror në nivelin lokal (bashkiak), si pjesë e një sistemi efektiv të integruar të mbrojtjes sociale. Zbatimi dhe koordinimi i këtij programi drejtohet nga PNUD.



Përmbajtja

Hyrje	4
1. Baza ligjore për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel lokal	7
2. Analizë e trendeve të financimit të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar.....	9
3. Analizë e buxhetit të bashkisë Skrapar sipas klasifikimit ekonomik dhe programeve	12
3.1. Struktura e të ardhurave për vitin 2020	12
3.2. Struktura e shpenzimeve buxhetore.....	15
4. Vlerësimi i mundësive për financimin e Planit Social të bashkisë.....	16
5. Rekomandime për mirëplanifikimin e shpenzimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë Skrapar	20
6. Plani Social 2020-2022 dhe vlerësimi i mundësive për financimin e tij.....	21

Hyrje

Gjatë viteve 2016-2018 janë shënuar një sërë reformash të rëndësishme në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri. Në vitin 2016 u miratua ligji për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Për të përmbushur synimin e krijimit të një sistemi të integruar të kujdesit shoqëror, ky ligj¹ përkufizon dhe detajon shërbimet, rolin e përgjegjësitë ligjore të të gjithë aktorëve të përfshirë në krijimin e kushteve dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në nivel qendror dhe vendor.

Këto shërbime përfshijnë ofrimin e shërbimeve parashoqërore, shërbime në qendrat komunitare dhe ato të zhvillimit, në qendrat rezidenciale dhe strehëzat, shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët, shërbime të specializuara, shërbime të këshillimit me telefon dhe online në qendrat multifunkionale etj., për fëmijët në nevojë, viktimat e dhunës, abuzimit, trafikimit, për gratë dhe të moshuarit.

Legjislacioni mbi shërbimet sociale përcakton qartë detyrimet specifike për shërbimin e kujdesit shoqëror në nivel vendor, që përfshijnë edhe ngritjen e njësive të referimit dhe vlerësimit të nevojave, (NJRVN), të mbrojtjes së fëmijës (NJMF), të dhunës në familje (NJDHF) me përgjegjësitë, dhe kërkesat profesionale përkatëse².

Për ta bërë edhe më të qartë se shërbimet e kujdesit shoqëror takohen me përfituesit në nivel lokal, atje ku janë fëmijët, gratë, të moshuarit në nevojë, si dhe personat me aftësi të kufizuar, dhe se bashkitë kanë përgjegjësinë ligjore të ofrojnë shërbimet e integruara sociale, në mars të vitit 2017 u nënshkrua Pakti Social mes gjithë kryetarëve të bashkive të Shqipërisë nga njëra anë dhe qeverisë, nga ana tjetër. Ky pakt shërben për të përforcuar zbatimin e ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror; ai është një udhëzues hap pas hapi i punës dhe detyrimeve që duhet të përmbushë përkatësisht qeveria dhe bashkia; zbatimi i tij shpreh dhe provon konkretisht vullnetin e bashkisë për të mbështetur grupet në nevojë pa ngurrim dhe me cilësi, sipas kërkesave ligjore.

Një nga hapat kryesorë në zbatimin e legjislacionit të kujdesit shoqëror ishte përgatitja dhe miratimi i Planeve sociale, gjatë viteve 2016-2020, në shumicën e bashkive. Planet sociale synojnë të krijojnë strukturat institucionale dhe mekanizmat e domosdoshëm administrativë në shërbim të grupeve të cënueshme, të identifikojë kostot dhe burimet financiare, në mënyrë që shërbimet e kujdesit shoqëror të ofrohen për familjet, fëmijët dhe grupet e tjera të cënueshme, sipas një projekti të hartuar në përputhje me realitetin, i cili monitorohet dhe përditësohet rregullisht.

¹ Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

² Ligji nr 163/2014 “Për urdhrin e Punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 40/2016 “Për urdhrin e Psikologëve në Republikën e Shqipërisë”

Plani social (PS) synon të jetë dokumenti orientues që udhëheq vendimmarrjen e bashkisë dhe qeverisë qendrore për të siguruar çdo mbështetje, institucionale, logjistike dhe financiare ndaj sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale që grupet e cënueshme dhe në nevojë të trajtohen sipas parashikimeve ligjore, dhe jo në mënyrë të improvizuar, të sforcuar dhe me vështirësi subjektive. Gjithashtu, Plani social orienton edhe mbështetjen nga donatorët, nga OJF-të dhe palët e treta.

UNDP e mbështetur nga programi “Joint SDG Fund” ka qenë ndër promotorët kryesorë të reformës në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në Shqipëri. Gjatë vitit 2018-2020 ka vazhduar të mbështesë zbatimin e reformës me projektin për rritjen e kapaciteteve të bashkive për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Në këtë kuadër, u përgatit edhe Plani Social I Bashkisë Skrapar I përgatit gjatë periudhës Maj-Gusht 2020.

Projekti ka siguruar nxitje për krijimin e strukturave institucionale dhe instrumenteve të përshtatshme për menaxhimin e shërbimeve shoqërore; ka ndihmuar bashkitë për të hartuar dhe zbatuar planet sociale, përmes mbështetjes teknike dhe orientuese. Projekti ka sjellë një kontribut të qenësishëm në krijimin e një klime dhe mentaliteti të ri në administratat vendore, në funksion të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror për fëmijët dhe grupet e tjera në nevojë dhe për të mundësuar ndryshimin e fokusit të punës nga transfertat në të holla te shporta e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe për të përmbushur objektivin kryesor të strategjisë kombëtare për Mbrojtjen sociale 2015-2020 për “krijimin e një shoqërie të mirëqenies së qëndrueshme, për sot dhe për nesër”.

Gjatë zbatimit të projektit është bërë një vlerësim i kapaciteteve financiare dhe mundësive për kontributin e bashkive në financimin e Fondit social – është kryer një analizë e buxhetimit të shërbimeve sociale në nivel kombëtar dhe veçanërisht në nivelin e NJQV-ve, bazuar në buxhetet vjetore dhe ato afatmesme për secilën NJQV - që u prezantua dhe u diskutua me ekipet e bashkive. Ky proces, përveçse krijoi një pamje të qartë për mundësinë e financimit të shërbimeve në nivel kombëtar dhe vendor, ndihmoi gjithashtu krijimin e një përvoje bashkëpunimi mes drejtorive të buxhetimit dhe financave me strukturat e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpër bashki.

Buxhetimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Bashkia Skrapar

1. Baza ligjore për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel lokal

Financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë mbështetet në ligjin nr. 9936 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, në ligjet vjetore për buxhetin e shtetit dhe në ligjin 13/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; në ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe në VKM nr. 111, 23.02.2018, “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social”.

Si institucion publik, bashkia, sipas ligjit 121, datë 24.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nëpërmjet strukturave të saj ka detyrimin të ofrojë dhe administrojë shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj, pra të planifikojë, të ndërtojë, të administrojë dhe mirëmbajë rregullisht këto shërbime përmes buxhetit të saj.

NJVV buxhetojnë shërbimet sociale bazuar në ligjin nr. 9936/2008 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimeve standarde të MF në këtë fushë, duke respektuar rregullat e qarta të ligjit 86/2017 “Për financat e VV”.

NJVV hartojnë PBA, ku programi social, si fushë/sector buxhetimi, është njëri prej sektorëve të tjerë të buxhetit të NJVV. Programi përfshin përgjegjësitë e bashkisë për realizimin e aktiviteteve që lidhen me këtë program dhe që mbështeten nga burime të sigurta fondesh nga të ardhura të veta, burime qendrore, donacione, marrëveshje bashkëpunimi etj.

Me miratimin e ligjit për shërbimet shoqërore, niveli vendor i qeverisjes ka rolin kryesor në ofrimin e këtyre shërbimeve ndaj grupeve vulnerabël, të cënueshme, në territorin e bashkisë dhe të njësive administrative. Bashkitë kanë funksionin e krijimit dhe administrimit të shërbimeve sociale në nivel vendor për shtresat në nevojë. Është përgjegjësi e bashkisë të kryejë identifikimin e nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e saj, hartimin e planeve sociale, programimin e buxheteve vendore, të përkufizojë shportën bazë të shërbimeve shoqërore, si dhe të kryejë kontraktimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Si burime financimi për shërbimet shoqërore në dispozicion të bashkive, për të përmbushur rolin dhe funksionet e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, janë përcaktuar fondet e deleguara nga buxheti i shtetit, përfshirë edhe fondin social dhe burimet e veta të financimit të njësive.

Është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ajo që i parashikon këto fonde në buxhetin e vet vjetor, duke ua shpërndarë bashkive që në fillim të vitit, mbështetur në aplikimin e tyre.

Fondet e buxhetit të shtetit për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror përcaktohen sipas vlerësimit të nevojave dhe mundësive të buxhetit të shtetit (neni 48). Në rastet kur ekonomia është ngadalësuar, apo prioritet mbetet ulja e deficitit, siç ka qenë politika e qeverisë gjatë viteve

të fundit, është e qartë se mundësitë e buxhetit të shtetit mbeten të vogla për të garantuar rritjen e financimit për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Fondi social³, një risi për sa i përket financimit të shërbimeve sociale, parashikon mobilizimin si burim financimi jo vetëm të fondeve publike dhe tarifave të përmendura më lart, por edhe kontribute jashtëbuxhetore nga organizata vendase apo të huaja ose persona të tjerë.

Për këtë arsye, një rol parësor në financimin e shpenzimeve të kujdesit shoqëror marrin bashkitë nëpërmjet burimeve të tyre të të ardhurave. Pra, burime të tjera të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përveç atyre të qeverisë qendrore, janë fondet nga buxhetet e njësive të qeverisjes vendore, të ardhurat nga pasuritë e veprimtari të tjera të bashkisë, si dhe nga tarifat e shërbimit për përfituesit e këtyre shërbimeve të kujdesit shoqëror.

³ Deri në kohën kur u përgatit ky dokument, ministria përkatëse nuk e kishte shpallur ende listën fituese nga fondet sociale.

2. Analizë e trendeve të financimit të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar

Shpenzimet e përkujdesit social në vitin 2020 janë programuar të jenë 4,08% e shpenzimeve totale të buxhetit të shtetit, ndërsa në vitin 2019 përbënin 4,52% të totalit të shpenzimeve. Deri në vitin 2018, këto shpenzime kishin shënuar një trend rënës, krahasuar me 5,1% të totalit të shpenzimeve që përfaqësonin në vitin 2015. Me përjashtim të vitit 2019, këto shpenzime janë gjithnjë më të ulëta se rritja e PBB nominale dhe, ç'është më e rëndësishmja, gjithnjë e më të ulëta sesa rritja e të ardhurave - pra, ekzistencës dhe rritjes së mundësisë për të kryer shpenzime buxhetore të lidhura me përkujdesjen sociale - dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit gjatë periudhës 2015-2018.



Tabela 1. Shpenzimet e kujdesit shoqëror kundrejt totalit të të ardhurave dhe shpenzimeve

	2015	2016	%	2017	%	2018	%	2019	%	2020	%
PBB nominal	1 427 799	1 475 251	3,32	1 525 868	3,43	1 647 525	7,97	1 752 736	6,39	1 581 000	(9,80)
Shpenzimet totale	437 408	433 697	(0,85)	461 410	6,39	497 069	7,73	519 577	4,53	579 500	11,53
Të ardhurat totale	379 206	407 021	7,34	430 397	5,74	464 703	7,97	486 677	4,73	446 500	(8,26)
Mbrojtja sociale (buxheti total)	131 437	137 516	4,63	141 306	2,76	148 603	5,16	156 556	5,35	162 818	4,00
Përkujdesi social Ministria	22 450	21 638	(3,62)	21 711	0,34	21 587	(0,57)	23 487	8,80	23 647	0,68
NE dhe PAK (buxheti total)	19 900	20 500	3,02	20 500	0	20 500	0	22 500	9,76	22 654	0,68


Burimi: Ministria e Financave, dokumentet e buxheteve vjetore

Deri në vitin 2019, shpenzimet për përkujdesjen shoqërore duket se nuk janë ndikuar nga miratimi në vitin 2016 i ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror. Në vitin 2016, këto shpenzime shënuan një tkurrje prej 3,62%, krahasuar me një vit më parë, pra më 2015. Në vitin në vijim (2017), shpenzimet e përkujdesjes shoqërore shënuan një rritje të lehtë me 0,34%, krahasuar me

vitin 2016 – në vitin 2017 u rikompozua qeveria dhe, nga Ministria e Punës, çështjeve sociale dhe shanseve të barabarta, përkujdesja shoqërore kaloi te Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Një vit më pas, më 2018, shpenzimet për përkujdesjen shoqërore u tkurrën përsëri me 0,57%. Për vitin 2020 pritet një rritje prej 0,68% e shpenzimeve të përkujdesjes shoqërore.



Ndihma ekonomike (NE) dhe pagesat për PAK përbëjnë komponentin kryesor të alokimit për financimin e programit buxhetor të Përkujdesit social. Pesha që NE dhe PAK së bashku zënë ndaj totalit të financimit të përkujdesjes sociale ishte në nivelin 88,64% në vitin 2015; në vitet 2016-2018, kjo peshë u stabilizua në mesatarisht 94,6%, ose qëndroi pa ndryshuar në rreth 20,5 miliardë lekë - ndihma ekonomike përbën rreth 22% të këtij totali, ndërsa pjesa tjetër prej 78% janë pagesat e PAK. Në buxhetin e vitit 2019, pesha e NE dhe PAK u rrit, duke arritur në 95,8% të totalit të financimit të programit buxhetor të përkujdesit social. Edhe në vitin 2020 ka një rritje shumë të lehtë të peshës së NE dhe PAK në buxhet, por duke qëndruar po në masën 95,8%.



Viti 2019 duket se është një pikë kthese në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror. Me miratimin e buxhetit të vitit 2019 u pa se shpenzimet për përkujdesin social u rritën me 8,8% krahasuar me

vitin 2018. Ndërsa në vitin 2020 kjo rritje është vetëm 0,68%. Përveç komponentëve tradicionalë (NE dhe PAK), që kanë pjesën më të madhe të financimit, buxhet i shtetit për vitin 2019 parashikoi për herë të parë zbatimin e ligjit për shërbimet shoqërore, duke alokuar rreth 150 milionë lekë për ngritjen e fondit social dhe rreth 100 milionë lekë për ndërmarrjet sociale. Megjithatë, shumica absolute e shtesës prej 8,8% në shpenzimet për përkujdesin social i kushtohet “bonusit të bebes”, një politikë e përshtatur nga qeveria për të frenuar rënien e fertilitetit në vend. Mbetet në angazhimin e çdo njësie vendore përfitimi i fondeve, atij social dhe të ndërmarrjeve, nëpërmjet skemës së aplikimit të projekteve konkrete, mbështetur në planet e tyre sociale.

3. Analizë e buxhetit të bashkisë Skrapar sipas klasifikimit ekonomik dhe programeve

Bashkia Skrapar është e organizuar në njësitë administrative: Qëndër Skrapar, Bogovë, Vëndreshë, Çepan, Potom, Leshnje, Gjerbës dhe Zhepë. Sipas të dhënave të gjendjes civile për vitin 2020, në bashkinë Skrapar ishin të regjistruar 16,992 banorë dhe vetëm 33% e popullsisë jetojnë në zone urbane. Bashkia Skrapar planifikon të ardhurat dhe shpenzimet për një periudhë trevjeçare, duke hartuar programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2020-2022.⁴

Ecuria e të ardhurave nga të gjitha burimet për periudhën 2017-2020 ka pësuar ndryshime të mëdha, nga niveli më i lartë prej 7.97% në 2018, duke u ulur deri në -8.26% për periudhën 2020.

Burimet kryesore për buxhetin e bashkisë janë transfertat nga buxheti i shtetit, të cilat përbëjnë mesatarisht 71% të buxhetit të përgjithshëm për vitin 2020 dhe përkatësisht 72% për vitin 2021 dhe 72,7% për 2022. Të ardhurat nga burimet e veta parashikohen në masën 28.8% ndaj totalit të të ardhurave.

Kjo ndarje e të ardhurave dëshmon një dominim të madh të të ardhurave të transferuara nga buxheti qendror, të cilat përbëjnë fondet e kushtëzuara, të pakushtëzuara, fondet për funksionet e deleguara.

3.1. Struktura e të ardhurave për vitin 2020

Buxheti i bashkisë për vitin 2020 parashikohet në shumën prej 329 milion (329.061.000) lekë nga të gjitha burimet e financimit, duke përfshirë edhe fondet e mbartura nga viti 2019.

Struktura e të ardhurave të veta:

Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë 28,87% të totalit të përgjithshëm dhe përfshijnë:

- të ardhurat nga taksat lokale, të cilat përbëjnë vetëm 3,53% të totalit të të ardhurave për vitin 2020 dhe mesatarisht 3,37% për periudhën në vijim,
- të ardhurat nga taksat e ndara, tarifat vendore dhe të ardhurat e tjera përbëjnë vetëm 25,34% të totalit të të ardhurave për vitin 2020 dhe mesatarisht 24,2% për periudhën në vijim,
- të ardhurat e mbartura përbëjnë 0% të totalit të të ardhurave të veta, nuk ka të ardhura të mbartura.

⁴ Sipas publikimeve në faqen zyrtare të bashkisë dhe Ministrisë së Financave.

Struktura e të ardhurave nga buxheti qendror:

Transferrat nga buxheti i shtetit përbëjnë 71,13% të totalit të përgjithshëm dhe përkatësisht:

- transferta e pakushtëzuar përbën 38,84%,
- transferta e kushtëzuar 2,02%,
- fondet speciale 30,2%.

Transferta e pakushtëzuar

Sipas ligjit 68/2017, “transferta e pakushtëzuar” është një transfertë e dhënë nga buxheti i shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi. Përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e NJVV, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

- Transferta e pakushtëzuar përbën 38,84% të totalit të buxhetit për vitin 2020 dhe për periudhën në vijim të PBA do të jetë në masën 41,45% të totalit të buxhetit.

Transferta specifike sipas funksioneve:

Sipas ligjit 68/2017, “transferta specifike” është një formë e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që përdoret vetëm për funksionin vendor për të cilin është dhënë dhe për rastet specifike të parashikuara në këtë ligj.

- Fondet speciale përbëjnë 30,2% të totalit të buxhetit për vitin 2020 dhe për periudhën në vijim të PBA do të jetë në masën 28,9% të totalit të buxhetit.

Transferta e kushtëzuar:

Sipas ligjit 68/2017, “transferta e kushtëzuar” është një transfertë nga buxheti i shtetit apo të tretë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, që përdoret vetëm për funksionin e deleguar, projekte të veçanta dhe sipas llogarisë ekonomike për të cilën është dhënë ose sipas përcaktimeve të legjislacionit apo marrëveshjes.

- Transferta e kushtëzuar përbën 2,02% të totalit të buxhetit për vitin 2020 dhe për periudhën në vijim të PBA do të jetë në masën 1,93% të totalit të buxhetit.

Tabela e mëposhtme na njeh në mënyrë të hollësishme me të gjitha burimet e financimit të bashkisë Skrapar.

Tabela 2. Buxheti i bashkisë Skrapar sipas burimit të financimit 2017-2022

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Të ardhura nga burimet e veta	97 451	70 719	107 577	95 000	95 000	95 000
Të ardhura nga taksat lokale	13 185	12 835	11 209	11 632	11 632	11 632
Të ardhura nga taksat e ndara (grante)	3 174	3 767	4 957	4 279	4 279	4 279
Të ardhura nga tarifa vendore	28 244	22 256	48 360	32 384	32 384	32 384
Të ardhurat e tjera	52 848	31 861	43 051	46 705	46 705	46 705
Të ardhura nga buxheti qendror	249 557	232 367	226 881	234 061	244 644	253 489
Transferta e pakushtëzuar	151 145	126 888	119 903	127 807	138 240	147 026
Transferta e kushtëzuar	6 091	5 768	6 635	6 635	6 693	6 752
Për funksionet e deleguara	6 091	5 768	6 635	6 635	6 693	6 752
Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	-	-	-	-	-	-
Transferta specifike	92 321	99 711	100 343	99 619	99 711	99 711
Huamarrja	-	-	-	-	-	-
Huamarrja afatshkurtër	-	-	-	-	-	-
Huamarrja afatgjatë	-	-	-	-	-	-
Trashëgimi nga Viti i shkuar	81 069	41 687	10 898	-	-	-
Trashëgimi pa destinacion	8 000	26 541	2 296	-	-	-
Trashëgimi me destinacion	73 069	15 146	8 602	-	-	-
Totali i burimeve buxhetore	428 077	344 773	345 356	329 061	339 644	348 489

3.2. Struktura e shpenzimeve buxhetore

Mbështetur në ligjin 139/2015, bashkia ka hartuar programin buxhetor afatmesëm 2020-2022, mbështetur në buxhetimin me programe. Për periudhën në vijim, bashkia do të mbështesë me buxhet vetëm 18 programe, ndër të cilat ato me financim më të lartë janë PAK, administrata, arsimi dhe transporti.

Shpenzimet e përgjithshme të vitit 2020, janë parashikuara në masën 329 milionë lekë ose 4,7% më pak sesa në vitin 2019. Shpenzimet kapitale janë parashikuar në masën rreth 53 milionë lekë dhe përbëjnë rreth 16% të buxhetit të përgjithshëm të bashkisë, ndërsa shpenzimet korrente 272 milionë ose 83% e totalit të buxhetit.

Shpenzimet për kujdesin shoqëror

Arkitektura e shpenzimeve për kujdesin shoqëror përbëhet nga financime të bashkisë dhe ato të qeverisë qendrore. Këto shpenzime janë të përfshira në 5 programe buxhetore, nga të cilat vetëm dy janë të buxhetuara si në tabelën 3.

- Në buxhetin afatmesëm të bashkisë Skrapar nuk janë parashikuar fonde për ngritje të shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror.

Shpenzimet për kujdesin shoqëror janë parashikuar në 6 924 mijë lekë, që përbëjnë 2,1% të totalit të shpenzimeve të parashikuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2020.

- Programi “Familja dhe fëmijët” përfshin shpenzimet totale për kujdesin shoqëror, të cilat detajohen më tej në shpenzime për PAK dhe NE.

Vërejmë se programe, si: sëmundje dhe paaftësi, të moshuarit, papunësia apo edhe strehimi, vijnë të jenë të pabuxhetuara edhe pse tashmë janë pjesë e planit social të bashkisë me aktivitete konkrete për të cilat mund të kërkohet financim pranë qeverisë qendrore.

Tabela 3. Buxheti shoqëror në vitet 2017-2022, sipas kategorive

Programet	2015	2016	2017	2018	2019	2020	% ndaj tot. të buxhetit/2020	% ndaj tot. të programit/2020
Sëmundje dhe paaftësi	-	-	-	-	-	-	0	0
Arsim	15 246	57 005	62 584	72 158	113 398	66 714	20,27%	87,27%
Të moshuarit	-	-	-	-	-	-	0	0
Familja dhe fëmijë	3 403	4 280	4 896	2 167	6 464	6 924	2,1%	9%
Papunësia	-	-	-	-	-	-	0	0
Strehimi	-	-	-	-	-	-	0	0
Ndihma ekonomike	-	2 594	2 697	2 776	2 790	2 806	0,85%	3,67%
Totali	18 649	63 879	70 177	77 101	122 652	76 444	23,23%	100%

Sipas të dhënave të bashkisë Skrapar rezulton që në territorin e kësaj bashkie nuk është ngritur asnjë qendër ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara. Numri i raportuar i fëmijëve me aftësi të kufizuara në këtë bashki është 32.

Fondi social dhe ndërmarrjet sociale

Jo vetëm ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, por edhe aktet nënligjore të miratuara në mbështetje të tij kanë kushtëzuar financimin nga qeveria qendrore të shërbimeve komunitare të bashkisë me ekzistencën e planit social të saj. Në mënyrë specifike, pika 4.3 e vendimit nr. 111 të Këshillit të Ministrave, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e fondit social” përcakton se “Ministria përgjegjëse për çështjet sociale parashikon në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, të cilat u transferohen njësisive të vetëqeverisjes vendore ku funksionojnë këto shërbime, bazuar në planet sociale të buxhetuara”.

- Bashkia Skrapar nuk ka kryer asnjë aplikim për përfitim fondesh si nga fondi social ashtu edhe nga ndërmarrjet sociale.

4. Vlerësimi i mundësive për financimin e Planit Social të bashkisë

Plani Social i Bashkisë Skrapar, 2020-2022, synon:

Qëllimi 1 : Deri në vitin 2022, të sigurojë funksionimin e programeve të shërbimeve sociale të përshtatshme dhe efektive në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, duke garantuar përdorimin e shërbimeve të larmishme dhe të cilësishme në përputhje me standartet kombëtare për të gjithë qytetraët në nevojë për shërbime.

Qëllimi 2: Deri në vitin 2022, të sigurojë ndërtimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

Qëllimi 3 : Të mundësojë rritjen e kërkesës për ofrimin dhe funksionimin e shërbimeve efektive, nëpërmjet ndërgjegjësimit të komuniteteve, grupeve të tjera të interesit dhe në veçanti të vetë grupeve në nevojë, nëpërmjet informacionit, këshillimit, konsultimit dhe bashkëpunimit.

Me qëllim arritjen e synimeve të formuluar më lart, Bashkia Skrapar duhet të realizojë disa aktivitete, të formuluar dhe të kostuara në planin e veprimit të Planit Social.

Në përputhje me Planin e Veprimit rezulton se Kosto e Përgjithshme e Planit Social është 103,910,000 lekë, sipas viteve në tabelën që vijon:

Tabela 4: Kosto e përgjithshme të Planit Social 2020-2022

	Gjithsej	2020	2021	2022
Qëllimi 1	94,940,000	10,860,000	43,490,000	40,590,000
Qëllimi 2	6,880,000	1,840,000	2,520,000	2,520,000
Qëllimi 3	2,090,000	470,000	890,000	730,000
Gjithsej	103,910,000	13,170,000	46,900,000	43,840,000

Burimi: Plani Social, Bashkia Skrapar

Analiza e të ardhurave të bashkisë konfirmon se:

Të Ardhurat gjithsej, viti 2020: 329,061,000 lekë

Nga buxheti qendror: 234,061,000 lekë (71%)

Nga burimet e veta: 95,000,000 lekë (29%)

Kosto e Planit Social për vitin 2020, prej 13,170,000 lekë, është sa 14% e të ardhurave të veta të Bashkisë për vitin 2020. Bashkia duhet të analizojë me kujdes drejtimet e përdorimit të të ardhurave të veta për të gjykuar nëse mund të financohet të paktën pjesërisht Plani Social për vitin 2020. Kosto e planit social për vitin 2021 është sa 45% e të ardhurave të veta (duke konsideruar të njëjtën shumë të të ardhurave) dhe sa 41% e të ardhurave të veta për vitin 2022.

Megjithatë, analiza duhet të përfshijë edhe të ardhurat e financuara nga transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, të cilat duhet të jenë objekt diskutimi në Këshillin Bashkiak si edhe ndërmjet Këshillit Bashkiak dhe Ministrisë së Financave dhe Partnerëve të tjerë institucionalë të bashkisë.

Tabela 5 sjell informacion mbi burimet e financimit të shpenzimeve sociale të bashkisë. Siç mund të konstatohet, Bashkia, ndonëse në mënyrë modeste financon arsimin, familjen dhe fëmijët si edhe një qendër sociale nga të ardhurat e veta. Shpenzime të tjera sociale financohen nga transfertat e kushtëzuara, pa kushtëzuara, të deleguara ose të ardhura specifike. Bashkia nuk financon shpenzime për kujdesin shëndetsor, të moshuarit dhe papunësinë.

Tabela 5: Shpenzimet sociale të bashkisë sipas burimit të financimit, 2015-2020(mijë lekë)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Shpenzimet sociale	0	0	0	0	0	0
A. Kujdes shëndetsor	0	0	0	0	0	0
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë						
2. Transferta të kushtëzuara						
3. Transferta të pakushtëzuara						
4.Funksione të deleguara						
5. Projekte						
6. Të ardhura specifike						
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
B.Arsim (Ar. 9 Vjeçar+Ar.Mesem,Konvikti)	3,250	70,648	71,805	72,158	71,583	98,475
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë	1,000	1,124	980	1,393	2,320	1,600
2. Transferta të kushtëzuara						
3. Transferta të pakushtëzuara	2,250	1,250	1,500			26,177
4.Funksione të deleguara						
5. Projekte						
6. Të ardhura specifike	0	68,273	69,325	70,765	69,262	70,698
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
C. Të moshuarit						
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë						
2. Transferta të kushtëzuara						
3. Transferta të pakushtëzuara						
4.Funksione të deleguara						

5. Projekte						
6. Të ardhura specifike						
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
D.Familje dhe fëmijë (Çerdhja)	3,925	4,080	4,312	4,372	4,288	6,006
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë	800	860	960	1,052	1,115	1,800
2. Transferta të kushtëzuara	3,125	3,220	3,352	3,320	3,173	4,206
3. Transferta të pakushtëzuara						
4.Funksione të deleguara						
5. Projekte						
6. Të ardhura specifike						
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
E.Papunësi						
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë						
2. Transferta të kushtëzuara						
3. Transferta të pakushtëzuara						
4.Funksione të deleguara						
5. Projekte						
6. Të ardhura specifike						
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
F.Strehim	0	0	0	2,625	2,360	2,429
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë				1,200	1,100	1,000
2. Transferta të kushtëzuara						
3. Transferta të pakushtëzuara				1,425	1,260	1,429
4.Funksione të deleguara						
5. Projekte						
6. Të ardhura specifike						
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
G.Ndihmë ekonomike	22,282	16,390	16,215	26,039	27,450	33,496
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë						
2. Transferta të kushtëzuara						
3. Transferta të pakushtëzuara						

4.Funksione të deleguara	22,282	16,390	16,215	26,039	27,450	33,496
5. Projekte						
6. Të ardhura specifike						
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
H.Aftësi e kufizuar	90,006	94,187	86,210	93,795	83,144	82,198
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë						
2. Transferta të kushtëzuara						
3. Transferta të pakushtëzuara						
4.Funksione të deleguara	90,006	94,187	86,210	93,795	83,144	82,198
5. Projekte						
6. Të ardhura specifike						
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
I.Shërbime të tjera sociale(Qendra Alternat)	0	0	2,150	2,166,	2,092	2,581
Sipas Burimit:						
1. Të ardhurat e Bashkisë			1,150	1,166	1,092	1,081
2. Transferta të kushtëzuara						
3. Transferta të pakushtëzuara			1,000	1,000	1,000	1,500
4.Funksione të deleguara						
5. Projekte						
6. Të ardhura specifike						
7.Nga Huamarrja						
8. Nga Trashëgimia e vitit të kaluar						
SHPENZIME GJITHSEJ	119,464	185,304	180,693	201,158	190,917	225,186

Burimi: Drejtoria e Tatim Taksa, bashkis Skrapar.

Në këto kushte, duket e vështirë të sigurohet financimi i Planit Social nga Buxheti i bashkisë. Çështja e financimit të Planit Social duhet të trajtohet si një çështje jo vetëm e bashkisë, pavarësisht kompetencave që I jep ligji Bashkisë. Çështja e financimit të planit social është e lidhur drejtëpërdrejtë me forcimin e sistemit të shërbimeve sociale në përputhje me Dokumentin Politik të Përfshirjes Sociale si edhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen shoqërore.

5. Rekomandime për mirëplanifikimin e shpenzimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë Skrapar

- Bashkia Skrapar duhet të miratojë pranë këshillit të bashkisë planin social, i cili është jo vetëm një detyrim që rrjedh nga ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në

Republikën e Shqipërisë”, por edhe një mundësi më shumë për ofrimin e shërbimeve në territor.

- Procesi i planifikimit dhe financimit të shpenzimeve për shërbimet e kujdesit shoqëror duhet të krijojë sinergji midis kërkesave të ligjit, planit social, PBA dhe buxhetit vjetor të bashkisë dhe fondeve të pushtetit qendror.
- Bashkia Skrapar duhet të angazhohet në projekte konkrete, për të bërë të mundur thithjen e fondeve nga fondi social dhe ai i ndërmarrjeve. kjo gjë do të mundësojë buxhetimin me aktivitete të programeve, siç janë të moshuarit apo papunësia, si dhe qendrat sociale, për të rritur fleksibilitetin në ofrimin e shërbimeve më të shumta e më cilësore ndaj familjeve e fëmijëve vulnerabël apo edhe të moshuarve. Ajo çka vërejmë, është se bashkia pothuajse nuk kontribuon me buxhet në programet sociale, por është administruese e fondeve të kushtëzuara.
- Bashkia nuk duhet të kufizohet vetëm në financimet e pushtetit qendror, të cilat lidhen me funksionet e përhershme të financuara, si PAK apo ndihma ekonomike. Në territorin e bashkisë Skrapar nuk u identifikua asnjë organizatë e cila ushtron aktivitet që ka në qendër grupet vulnerabël, apo që ofron shërbime jopublike të kujdesit shoqëror, çka e bën edhe më sfidues realitetin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë bashki.
- Bashkia duhet të krijojë Fondin social si një instrument efektiv i financimit të shërbimeve sociale.

7. Konkluzione përfundimtare.

Kërkesa për shërbime sociale në vendin tonë po rritet për shkak të ndryshimeve demografike dhe shoqërore, për shkak të ndikimit të krizës ekonomike dhe rritjes së shkallës së papunësisë, varfërisë dhe përjashtimit social. Në të njëjtën kohë, për të zbatuar masat shtrënguese, buxhetet publike po pakësohen dhe shpenzimet për shërbimet sociale janë shkurtuar në shumë bashki.

Nga analiza e fundit e kryer, rezulton se në territorin e disa bashkive nuk ofrohet ende asnjë shërbim social. Vendimi i fundit i qeverisë parashikon metodologjinë e re të financimit të shërbimeve sociale në territor nga buxheti i shtetit. Ai qartëson gjithashtu procedurat dhe kriteret se si do të përlllogariten fondet e nevojshme që bëjnë realitet këto shërbime, kudo ku ka nevojë për to. Kriteri kryesor është nevoja reale për këto shërbime, aty ku ato sot janë të pakta ose mungojnë tërësisht.

Fondi Social është mekanizmi financiar, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore, qëllimet e të cilit janë përmirësimi i standardeve të ofrimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, planifikimi i krijimit të shërbimeve të reja të munguara, si dhe zhvillimi i politikave sociale në nivel qendror dhe vendor. Një mekanizëm i tillë mundëson financimin në të gjithë territorin, duke balancuar edhe shpërndarjen e tij sipas nevojave në nivel lokal.

Një nga hallkat më të rëndësishme për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel lokal, është organizimi dhe funksionimi i strukturave përgjegjëse në bashki, në përputhje me detyrimet ligjore. Ngritja dhe funksionimi i këtyre strukturave është pjesë e planeve sociale të formuluarë e që po zbatohen nga bashkitë përkatëse.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore. Njësitë e qeverisjes vendore janë të rrezikuara përsa i përket aspektit financiar, duke qenë se pothuajse gjysmën e burimeve buxhetore i parashikojnë nga të ardhurat e veta dhe realizimi i buxhetit është i lidhur ngushtësisht me nivelin e realizimit të të ardhurave.

Mungesa e burimeve financiare të mjaftueshme për shërbime të shpërndara dhe të shumëllojshme të përkujdesit mbetet një problematikë serioze në situatën e shërbimeve sociale në bashkinë e Skraparit.

Duke analizuar situatën e shërbimeve aktuale rezulton se një pjesë e konsiderueshme e grupeve në nevojë mbeten në nivele të pamjaftueshme apo plotësisht të pa mbuluara me shërbime në territorin aktual të bashkisë së Skraparit. Disa nga këto janë shërbimet për familjet e varfëra, për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbimet për të pastrehët, për të papunët, shërbimet për të moshuarit, etj. Marrja e masave për uljen e varfërisë dhe nxitjen e përfshirjes sociale duhet të jetë një nga objektivat kyçe të bashkisë së Skraparit.

Sa më shumë të investohet në kapitalin njerëzor, në zhvillimin e aftësive të fuqisë punëtore nëpërmjet arsimit dhe në përmirësimin e produktivitetit nëpërmjet një qasjeje më të mirë në

shërbime shëndetësore dhe ushqim, në strehim dhe mbrojtje sociale aq më tepër do të tkurret terreni i përjashtimit social. Sidoqoftë, jo të gjitha kostot e parashikuara për këto shërbime janë financuar në mënyrë efektive.

Buxhetet publike duhet të sigurojnë mbështetje të përshtatshme financiare për ofrimin e shërbimeve sociale, pasi kjo paraqet një investim efektiv dhe një element thelbësor të shoqërive kohezive dhe elastike.